




STRUKTURA E POSAÇME  
KUNDËR KORRUPSIONIT  
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

# RAPORTI VJETOR 2021

Mars 2022



## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje .....	4
<b>1. Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftë Kundër Kriminalitetit .....</b>	<b>6</b>
1.1 Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë.....	6
1.2 Rekomandimet e Këshillit të Ministrave .....	9
2. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në hetim... 11	
3. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në gjykim. 14	
4. Ekzekutimi i vendimeve penale .....	16
a. Konfiskim i pasurisë në proces penal .....	16
b. Kërkesat e paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë për vendosjen në regjim të posaçëm dhe vendimarrja përkatëse e Ministrit të Drejtësisë.....	17
c. Praktika administrative të ndryshme të zgjidhura gjatë vitit 2021.....	18
<b>5. Përgjimi i komunikimeve elektronike në kuadër të hetimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2021 .....</b>	<b>19</b>
6. Sektorit i Ekspertizës në Prokurorinë e Posaçme. ....	24
7. Aktiviteti administrativ i Prokurorisë së Posaçme për trajtimin e ankesave të paraqitura 24	
8. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta .....	26
9. Bashkëpunimi me projektet e huaja të asistencës.....	31
10. Aktiviteti i Koordinatorit për Mediat në SPAK.....	35
11. Veprimtaria e Komisionit të Përzgjedhjes së Hetuesve të BKH-së .....	36
12. Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 2021. ....	37
13. Aktiviteti i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit .....	38
14. Plotësimi me personel administrative i Prokurorisë së Posaçme.....	41
15. Analizë e të dhënave buxhetore të SPAK për vitin 2021 .....	42
a. Shpenzimet e personelit .....	46
b. Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera .....	47
c. Transferta për buxhete familjare .....	47
d. Shpenzime për Investime Kapitale .....	47
e. Ndihma e Huaj .....	48
f. Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 .....	49
16. Të dhëna Statistike dhe grafikët përkatës.....	51
TABELA 1 .....	55
TABELA 2 .....	56
TABELA 3 .....	61

<b>TABELA 4</b> .....	63
<b>TABELA 5</b> .....	69
<b>TABELA 6</b> .....	72
<b>TABELA 7</b> .....	75
<b>TABELA 8</b> .....	76



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË**  
**ORGANIZUAR**

**RAPORT**  
**MBI VEPRIMTARINË E PROKURORISË SË POSAÇME GJATË VITIT 2021**

## **Hyrje**

Bazuar në përcaktimet e neneve 104 dhe 105 të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, është përgatitur “Raporti mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme gjatë vitit 2021”. Në raport paraqiten treguesit e punës, gjendja e kriminalitetit sipas juridiksionit përkatës dhe ecuria e veprimtarisë së strukturës. Raporti i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Prokuroria e Posaçme ka ushtruar funksionet e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu nga SPAK janë mbajtur parasysh Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, si dhe prioritetet e shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka patur një rol mjaft aktiv. Institucioni ka ardhur duke u konsoliduar në mënyrë të vazhdueshme dhe duke dhënë rezultate konkrete, të dukshme në ushtrimin e ndjekjes penale kundër korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, abuzimit me fondet publike dhe hetimeve pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Rezultatet janë arritur falë përkushtimit maksimal të prokurorëve, hetuesve të BKH-së dhe stafit administrativ mbështetës në punën e tyre.

Janë marrë masat e duhura për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i Prokurorisë, si dhe në drejtim të rritjes së efektivitetit të punës së prokurorëve në seancat gjyqësore. Në çdo rast janë marrë masat për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit në mënyrë që të rritet efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale, duke garantuar dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke vlerësuar faktin se ushtrimi me efektivetit të ndjekjes penale brenda kompetencave që ajo ka mund të realizohet vetëm në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda vendit, ka patur si objektiv dhe ka realizuar bashkëpunim të ngushtë dhe efektiv me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të

Prandalimit të Pastrimit të Parave, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimin Informativ Shtetëror, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si dhe institucionet e tjera ligjzbatuese.

Prioritet tjetër i rëndësishëm i punës së Prokurorisë së Posaçme gjatë vitit 2021 ka qënë konsolidimi dhe rritja e bashkëpunimit me autoritetet e huaja që veprojnë fushën e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe terrorizmit. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme dhe efektive me autoritetet italiane, amerikane, gjermane, hollandeze, belge, angleze, franceze, EUROJUST, EUROPOL, etj. Si rezultat janë regjistruar procedime penale të shumta, janë kryer hetime të përbashkëta dhe janë kryer aksione të përbashkëta në goditjen e aktivitetit kriminal të organizuar dhe me shtrirje ndërkombëtare.

Në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2021 kanë ushtruar funksionin 15 (pesëmbëdhjetë) prokurorë. Bazuar në përcaktimet e nenit 40/2 (Dispozita kalimtare) të ligjit Nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, kanë ushtruar funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme 13 (trembëdhjetë) oficerë të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore të ish-Prokurorisë për Krime të Rënda, nga Janari deri në Gusht 2021. Në Shtator 2021 kanë filluar detyrën 28 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Gjatë vitit 2021 në Prokurorinë e Posaçme kanë ushtruar funksionet e tyre mbështetëse edhe stafi administrativ prej 54 punonjësish me emërim dhe me kontratë.

Prokuroria e Posaçme është e vendosur të forcojë dhe konsolidojë arritjet e saj dhe gjatë vitit 2022. Prokurorët, hetuesit dhe stafi administrative janë të përkushtuar në maksimum në objektivat e vendosura dhe arritjen e tyre. Lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar, terrorizimit, pastrimit të parave dhe konfiskimi i pasurive që rrjedhin nga aktiviteti kriminal do jenë prioritete kryesore në punën tonë.



## **1. Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftë Kundër Kriminalitetit**

### **1.1 Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë**

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në funksion të kryerjes me efektivitet të detyrave të saj kushtetuese dhe ligjore ka vlerësuar dhe implementuar rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, të dhëna nëpërmjet “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020”, të miratuar në seancën plenare të datës 14.06.2021. Në këtë rezolutë, janë adresuar edhe rekomandime për të cilat është kërkuar bashkërendim/bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme.

- a. Në lidhje me rekomandimin “.....Të merren masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.”

Gjatë vitit 2021, nga ana e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë filluar kryesisht 15 procedime penale, që janë rreth 5%, e totalit të procedimeve penale të regjistruara për këtë vit.

- b. Në lidhje me rekomandimin “.....rritja më tej e efikasitetit të veprimtarisë ndërinstitucionale dhe të efektivitetit në hetimet dhe ndjekjen penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, në vijim të zbatimit të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF).”

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka patur një rol mjaft aktiv si institucion kontribues dhe raportues në zbatim të planit të veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (ICRG/FATF).

Në lidhje me veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale duhet theksuar se vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal nuk është në kompetencën lëndore të hetimit të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër penale hetohet nga Prokuroria e Posaçme vetëm kur kryhet nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur (neni 75/a gërma b e Kodit të Procedurës Penale), ose nga subjekte të posaçme sipas parashikimeve të nenit 75/a gërmat c dhe ç të Kodit të Procedurës Penale).

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar 15 procedime penale ku përfshihet hetimi i veprës penale të pastrimit të produkteve

të veprës penale. Janë hetuar 25 persona. Janë përfunduar dhe dërguar për gjykim 3 procedime penale me 7 të pandehur.

Në lidhje me hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale.

Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka vepruar në 3 drejtime kryesore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale :

- Në zbatim të ligjit 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjatë vitit 2021, janë hetuar 316 materiale pasurore. Janë paraqitur dhe janë miratuar nga Gjykata 14 kërkesa për sekuestrimin e pasurive. Gjithashtu janë paraqitur 4 kërkesa për konfiskimin e pasurive.

- Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, “Për Masat Parandaluese në Kuadër të Forcimit të Luftës Kundër Terrorizmit, Krimin të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe konsolidimit të Rendit e Sigurisë Publike.

Gjatë vitit 2021 nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar janë paraqitur në gjykatë 25 kërkesa për sekuestrim pasurie, si dhe 72 kërkesa për konfiskimin e pasurisë në zbatim të këtij Akti Normativ.

- Në zbatim të dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale (sekuestrime dhe konfiskime pasurie në procesin penal).

Përgjatë vitit 2021, nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është kërkuar në 4 raste sekuestrim në proces penal, kërkesa të cilat janë pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në 1 rast, sekuestrimi është vendosur nga vetë prokurorët e posaçëm.

- c. Në lidhje me rekomandimin “..Të forcohen kapacitetet institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre nëpërmjet vijimit të punës së nisur për shmangien e efekteve të krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, bashkëvendimit dhe koordinimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas rregullave të përcaktuara në ligj.”

Në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, që nga momenti i krijimit të saj në dhjetor 2019, nuk ka problematika që lidhet me uljen e numrit të prokurorëve për shkak të procesit kalimtar të rivlerësimit, pasi kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit është kusht për emërimin në detyrë të prokurorëve të kësaj strukture. Gjithsesi në Prokurorinë

e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar edhe përgjatë vitit 2021 u konstatua mosplotësimi i numrit të miratuar të prokurorëve që është 20. Gjatë këtij viti u bë emërimi i 3 prokurorëve duke e çuar numrin e tyre në 17.

- d. Në lidhje me rekomandimin “...Të standardizohen procedurat e funksionimit nga pikëpamja administrative për unifikimin e volumit të punës dhe normalizimin e veprimtarisë në prokurori nëpërmjet përgatitjes së një udhëzimi të përgjithshëm “Për përcaktimin e normës/volumit orientues të punës në prokurori”, me synim përcaktimin e normës e volumit të punës orientuese për prokurorët në sistemin e juridiksionit të përgjithshëm sipas standardeve europiane.”

Përsa i përket Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, shpërndarja e materialeve hetimore, bëhet nga Drejtuesi i Prokurorisë, nëpërmjet shortit manual, në kushtet e transparencës së plotë. Me qëllim shpërndarjen e drejtë të ngarkesës së punës bëhet edhe caktimi i materialeve hetimore, sipas parashikimeve të nenit 15.1.b të ligjit 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

- e. Në lidhje me rekomandimin “...Të evidentohen shqetësimet dhe vështirësitë që hasin prokurorët dhe/ose oficerët e Policisë Gjyqësore në prokuroritë e të gjitha niveleve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grupvepra penale dhe të organizojë trajnime të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve, krahas trajnimeve vazhduese të prokurorëve bazuar në programin e Shkollës së Magjistraturës. Bashkëpunimi dhe mbështetja e misioneve dhe projekteve ndërkombëtare që asistojnë prokurorinë është e mirëpritur.”

Gjatë vitit 2021, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kanë qenë pjesëmarrës në kurset e trajnimit vazhdues të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Prokurorët dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë ndjekur edhe kurse trajnime të organizuara nga Icitap, Pameca V dhe Euralius. Bashkëpunimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me misione që asistojnë prokurorinë Opat, Icitap, Euralius, Pameca, është i qëndrueshëm dhe në nivele shumë të larta.

- f. Në lidhje me rekomandimin “.....Të forcohet bashkërendimi, koordinimi dhe roli monitorues i Prokurorisë për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të prokurorisë në përputhje me parashikimet ligjore, duke e vënë theksin tek rritja e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe KLP-në në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore ose etike dhe adresimit të problemeve që hasen në prokuroritë e të gjithave niveleve.”

Gjatë vitit 2021 bashkëpunimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe KLP-në, ka qenë shumë efektiv. Kjo ka konsistuar në ndihmë që u jep Prokuroria e Posaçme këtyre institucioneve nëpërmjet dhënies në kohë reale të informacioneve të kërkuara e që lidhen me verifikimin e subjekteve për të cilët kryhen verifikime për shkelje të natyrës disiplinore.



Edhe për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e ankesave janë kryer verifikime nga Inspektori i Lartë të Drejtësisë, por nuk kanë rezultuar elementë për fillimin e procedimeve disiplinore.

- g. Në lidhje me rekomandimin “...Të ndërmerren hapa konkretë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Policinë e Shtetit, gjykatat dhe institucionet e tjera shtetërore për të filluar krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare.”

Gjatë vitit 2021 përfaqësues të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kanë qenë pjesëmarrës aktivë në grupet e punës me qëllim krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare

- h. Në lidhje me rekomandimin “...Të përshpejtojë punën e nisur për identifikimin e problemeve në “sistemin e menaxhimit të çështjeve” (CAMS) dhe të marrë masa konkrete të një sistemi funksional sipas nevojave të organit të prokurorisë dhe për të mundësuar digjitalizimin e informacionit.”

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si institucion i pavarur nga Prokuroria e Përgjithshme nuk është pjesë e “sistemit të menaxhimit të çështjeve” (CAMS), por gjatë vitit 2021 është punuar dhe vazhdohet të punohet për një sistem që do të shërbejë në funksion të menaxhimit të çështjeve të Prokurorisë së Posaçme.

- i. Në lidhje me rekomandimin “...Të nxitet dhe të bashkëpunohet për ngritjen e strukturave hetimore nga Policia e Shtetit sipas ligjit.”

Gjatë vitit 2021 bashkëpunimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me Policinë e Shtetit e sidomos me strukturat qendrore të saj ka qenë i niveleve shumë të larta dhe shumë të kënaqshme. Edhe pse struktura hetimore e Prokurorisë së Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit, filloi funksionimin në muajin gusht 2021, sërisht bashkëpunimi me Policinë e Shtetit është një domosdoshmëri e padiskutueshme në efektivitetin e ndjekjes penale të veprave të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Edhe në vazhdim ky bashkëpunim do të jetë në nivelet maksimale.

## 1.2 Rekomandimet e Këshillit të Ministrave

**Gjatë vitit 2021 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit ka analizuar dhe vlerësuar edhe rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 të adresuara nga Këshilli i Ministrave me anë të V.K.M 326 datë 02.06.2021.**

Këto rekomandime janë dhënë në 5 drejtime kryesore:

**Drejtimi i parë:** Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit;

**Drejtimi i dytë:** Lufta kundër korrupsionit;

**Drejtimi i tretë:** Lufta kundër krimit të organizuar;

**Drejtimi i katërt:** Respektimi i të drejtave të njeriut;

**Drejtimi i pestë:** Bashkëpunimi ndërinstitucional.

Në lidhje me drejtimin e parë e që lidhet me garantimin e pavarësisë së prokurorit, përkrah detyrimeve ligjore qartësisht të parashikuara në ligj gjatë mbledhjeve të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme është vënë theksi në shtimin e rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht nga vetë prokurorët si dhe kontrolli efektiv në punën e OPGJ-ve dhe hetuesve të BKH-së.

Në lidhje me drejtimin e dytë e që lidhet me forcimin e luftës kundër korrupsionit, gjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme ka qenë plotësisht e fokusuar në hetimin, sidomos me metoda proactive, të veprave penale në fushën e korrupsionit e sidomos të korrupsionit në nivele të larta. Gjatë këtij viti janë kryer hetime të suksesshme si dhe kanë përfunduar duke u deklaruar fajtorë gjykime për subjekte të cilët kanë ushtruar funksione të larta shtetërore.

Gjatë vitit 2021 duke qenë edhe vit zgjedhor janë ndjekur me përparësi materiale për referimin e veprës penale dhe kallëzimeve penale mbi ekzistencën e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese.

Në lidhje me drejtimin e tretë e që lidhet me forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, gjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme ka patur në fokus forcimin e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike, si nëpërmjet hetimit të veprave penale dhe personave të implikuar ashtu edhe ndaj pasurive të krijuara si rezultat i kësaj veprimtarie kriminale. Gjatë këtij viti është rritur bashkëpunimi me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve. Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar i është dhënë prioritet krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja të drejtësisë, nën mbikëqyrjen dhe mbështetjen e Eurojust.

Si një institucion raportues dhe kontribues Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2021 është angazhuar në përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval-it për pastrimin e parave.

Në lidhje me drejtimin e katërt e që lidhet me forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut, Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2021, bazuar edhe në kompetencat e saj ka patur në fokus kryerjen e hetimeve të shpejta, efektive për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Në lidhje me drejtimin e pestë e që lidhet me forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional është fokusur në shkëmbimin e të dhënave, kryerjen e analizave të përbashkëta për rastet e referuara, me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe lehtësimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e pastrimit të parave.

Fokus të veçantë ka patur edhe në koordinimin ndërinstitucional në lidhje me të dhënat statistikore, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integritetit të vendit.

## **2. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në hetim**

Në Prokurorinë e Posaçme për periudhën e vitit 2021 janë hetuar gjithsej 715 procedime penale, nga të cilat 352 procedime penale janë mbartur nga viti 2020, ndërsa 363 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2021 si procedime penale të reja.

Nga 363 procedime penale të reja të filluara në vitin 2021, 70 procedime penale janë dërguar për kompetencë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, procedimet penale të tjera janë filluar mbi bazën e referimeve penale të shërbimeve të policisë gjyqësore, të kallëzimeve penale të institucioneve të ndryshme, enteve private dhe të shtetasve. Nga Prokuroria e Posaçme janë regjistruar kryesisht 18 procedime penale. Është vendosur mospranimi i akteve për 24 procedime penale të dërguara për kompetencë lëndore nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, të cilat janë ridërguar në prokuroritë kompetente.


Në Prokurorinë e Posaçme janë rregjistruar në vitin 2021 gjithsej 344 kallëzime/referime penale për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 121 kallëzime/referime penale, për 217 kallëzime/referime penale është rregjistruar procedim penal, ndërsa për 6 kallëzime penale është vendosur dërgimi i materialit kallëzues për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.

Për vendimet e mosfillimit të procedimit penal është paraqitur ankim në Gjykatë në 55 raste, nga të cilat për 47 vendime për mosfillimin e procedimit penal është vendosur lënia në fuqi nga ana e Gjykatës, 4 vendime mosfillimi janë shfuqizuar nga Gjykata, ndërsa për 4 vendime të tjera ka vazhduar procedura e gjykimit të ankimeve për vitin 2022.

Nga 715 procedime penale të hetuara për vitin 2021, për 40 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke pasur në hetim për këtë periudhë kohore gjithsej 675 procedime penale në hetim, me 519 persona nën hetim.


Gjatë kësaj periudhe kohore kanë përfunduar hetimet për 226 procedime penale me 332 persona nën hetim, ku për 48 procedime penale është paraqitur kërkesë për gjykim, për 37 procedime penale është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes, 107 procedime penale janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, për 34 procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve. Ndërsa, 449 procedime penale janë mbartur në hetim në vitin 2022.

### Treguesit e mënyrës së përfundimit të procedimeve penale



Për 48 procedimet penale të dërguar për gjykim, janë marrë të pandehur gjithsej 239 persona, nga të cilët 14 çështje penale me 84 të pandehur janë akuzuar për vepra penale të lidhur me krimin e organizuar, 33 çështje penale me 96 të pandehur janë akuzuar për vepra penale që lidhen me korrupsionin, ndërsa 1 çështje penale e cila lidhet me subjekte të posaçme, dhe 59 të pandehur gjithsej që lidhen me raste të të pandehurve në procedime penale të lidhura, janë të dërguara në gjykim për vepra penale të tjera.

### Të pandehurit e dërguar në gjyq sipas veprave penale




Në 37 procedimet penale për të cilët është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes kanë qënë nën hetim 53 persona, 2 kërkesa për pushim me 12 persona nën hetim për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, 24 kërkesa për pushim me 11 persona nën hetim për vepra penale të lidhen me korrupsionin, 11 kërkesa për pushim dhe 30 persona nën hetim për vepra penale të tjera.

Në 107 procedimet penale që janë transferuar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë qënë 40 persona nën hetim, 8 procedime penale me 2 persona nën hetim për vepra në fushën e krimin të organizuar, për 35 procedime penale me 21 persona nën hetim për vepra në fushën e korrupsionit, për 64 procedime penale me 17 persona nën hetim për vepra penale të tjera.

Nga 34 procedimet penale për të cilat është vendosur pezullimi i hetimeve, 22 procedime penale kanë qënë të regjistruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, ndërsa 9 procedime penale kanë qënë të regjistruara për vepra penale që lidhen me korrupsionin, si dhe 3 procedime penale për vepra penale të tjera.

Nga **519 persona nën hetim** që janë hetuar gjatë vitit 2021, kanë përfunduar hetimet për **332 persona nën hetim/të pandehur**, që i korrespondon rreth **64 % e numrit total të personave** në hetim, ndërsa për vitin 2022 janë mbartur hetimet për 187 persona nën hetim.

### Vendimarrja lidhur me persona të hetuar/akuzuar




Nga numri prej 519 persona nën hetim, 339 prej tyre janë hetuar me masë sigurimi, ndërsa 180 persona nën hetim janë hetuar në gjendje të lirë. Nga personat nën hetim të hetuar me masë sigurimi, 218 persona janë hetuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, nga të cilat 202 janë ekzekutuar ndërsa për 16 persona është vendosur masa e sigurimit në mungesë dhe nuk janë ekzekutuar.

Masa e sigurimit “arrest në burg” për 108 persona është vendosur për vepra penale të lidhura me krimin e organizuar, për 52 persona është vendosur për vepra penale të lidhura me korrupsionin, ndërsa për 42 persona është vendosur për vepra penale të tjera.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është vendosur për 48 persona nën hetim, 67 persona nën hetim janë hetuar me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, 1 person për masën e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, 5 persona me masën e sigurimit “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”.





Për vitin 2022 janë mbartur në hetim 449 proçedime penale me 187 persona nën hetim. Nga këto, 118 procedime penale janë të regjistruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar me 66 persona nën hetim, nga të cilët 43 prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest në burg”. Nga proçedimet penale të mbartura, 235 proçedime penale me 64 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të korrupsionit. Ndërsa, 96 procedime penale me 57 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të tjera.

Në grupin e veprave penale të proçedimeve penale të mbartura, numërin me të lartë e mban vepra penale e parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, me 78 proçedime penale, që pasohet me 63 proçedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.


Nga 187 persona nën hetim në procedimet penale të mbartura, 75 persona nën hetim janë duke u hetuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, 13 persona me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, 15 persona me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, 4 persona me masë sigurimi pezullim “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”, 80 persona në gjendje të lirë pa ndonjë masë sigurimi.

### **3. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumi i punës në gjykim**

**Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,** për vitin 2021, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e 128 çështje penale themeli, me 418 persona të akuzuar. Ka përfunduar gjykimi i themelit për 76 çështje penale me 233 persona të akuzuar. Për 5 çështje penale të tjera me 9 persona të pandehur është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe janë dërguar për kompetencë në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore. Ndërsa, për 47 çështje penale themeli me 176 të pandehur gjykimi nuk ka përfunduar, duke u mbartur për tu gjykuar në vitin 2022.


Përveç çështjeve penale të mësipërme prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në edhe në gjykimin e 13 çështjeve penale me të dëmtuar akuzues, që kanë paraqitur kërkesë drejtëpërsëdrejti në gjykatë, me 19 persona të akuzuar.

### Treguesit për numërin e çështjeve penale në gjykim



Në 76 çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë dënuar gjithsej 230 persona. Nga këto, 23 çështje penale me 94 persona kanë qënë për vepra penale në fushën e krimin të organizuar, ndërsa 52 çështje penale me 136 persona kanë qënë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

### Treguesit për personat e dënuar



**Pafajësitë.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka dhënë pafajësi të plotë në 1 çështje penale, për 1 person të akuzuar (vendimi nr.63, datë 20.10.2021), si dhe është dhënë pafajësi për 1 të pandehur në një çështje penale me disa persona të akuzuar (vendimi nr.90, datë 28.12.2021). Po kështu, është dhënë pafajësi e pjesëshme për 10 të pandehur të tjerë, të gjykuar në të njëjtën çështje penale, për të cilët gjykata i ka dënuar pjesërisht për disa akuza dhe deklaruar të pafajshëm për akuza të veçanta (vendimi nr.12, datë 03.02.2021).

**Pushimet në gjykim.** – Nuk ka pasur asnjë rast të pushimit të çështjes në gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

**Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,** për vitin 2021, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjeve penale të themelit, si dhe në gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për kërkesat e prokurorisë gjatë fazës së hetimeve paraprake. Për vitin 2021 në Gjykatën e Apelit ka përfunduar gjykimi për 41 çështje penale themeli, me 116 persona të akuzuar dhe të dënuar. Nga këto çështje penale për të cilat është përfunduar gjykimi në apel 19 çështje penale me 71 të pandehur kanë qënë për vepra penale të krimit të organizuar, ndërsa 22 çështje penale me 44 të pandehur kanë qënë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

**Në Gjykatën e Lartë** gjatë vitit 2021 prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në gjykimin e 4 çështjeve penale.

**Në Gjykatën Kushtetuese** gjatë vitit 2021 prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në 2 raste.

#### **4. Ekzekutimi i vendimeve penale**

Në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është caktuar një specialist për ekzekutimin e vendimeve penale. Specialisti ndihmon prokurorët në nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kryen detyra administrative, si dhe mban të dhëna statistikore në lidhje me ekzekutimet e kryera. Të dhëna statistikore në lidhje me ekzekutimet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë gjatë vitit 2021 janë si më poshtë :

- Nga Janari i vitit 2021 deri më 31.12.2021, janë ekzekutuar 77 vendime gjykate të formës së prerë. nga këto 36 vendime kanë marrë formë te prerë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës te Pare dhe 41 vendime në Gjykatën e Posaçme të Apelit.
- Janë dënuar me vendim të formës së prerë **171 të pandehur, nga të cilët :**
  - a. me burgim janë dënuar 114 persona.
  - b. me kusht, kohë prove janë dënuar 40 persona.
  - c. me orë pune janë dënuar 17 persona.
- Gjatë vitit 2021, përveç deklarimit fajtor dhe masës së dënimit me burg apo me kohë prove, është dhënë dhe dënimi plotësues “**ndalimi për të ushtruar funksion publik**”, në bazë të nënit 35 të Kodit Penal për **13 persona.**

##### **a. Konfiskim i pasurisë në proces penal**

**Është dhënë konfiskim pasurie në proces penal, në 41 vendime penale.**

##### **1. Pasuri të paluajtëshme të konfiskuara**

- a. Apartamente 4 (katër).
- b. Bar resorante, hotel 4( katër) kate + podrum.
- c. Lokal 300 m<sup>2</sup>.
- d. Lokal me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>.
- e. Ndërtesë pularie 1 (një).
- f. Tokë me sipërfaqe 22.300 m<sup>2</sup>

## **2. Vlera monetare të konfiskuara në lek, euro dhe dollar.**

- a. 20.191.231 leke (njëzetë milionë e njëqindë e nëntëdhjetë e njëmijë e dyqind e tridhjetë e një)
- b. 189.811 euro (njëqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e njëmbëdhjetë)
- c. 38.101 usd (tridhjetë e tetë mijë e njëqind e një)

## **3. Pasuri te luajtëshme të konfiskuara**

- a. Automjete 15 (pesëmbëdhjetë)
- b. Aparate celulari 64 (gjashtëdhjetë e katër)
- c. Laptop 10 (dhjetë)
- d. Printer 7 (shtatë)
- e. Skaner 5 (pesë)
- f. Njësi kompjuterike 7 (shtatë)
- g. Bizhuteri të ndryshme 49 (dyzet e nëntë)
- h. Orë dore 26 (njëzet e gjashtë)
- i. Një aparat fotografik
- j. Një kamer
- k. Nje plastifikues dokumentash

## **b. Kërkesat e paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë për vendosjen në regjim të posaçëm dhe vendimarrja përkatëse e Ministrit të Drejtësisë.**

- a. Janë paraqitur kërkesa nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për zgjatjen e afatit të regjimit të posaçëm dhe janë konfirmuar me vendim nga Ministri i Drejtësisë për 4 (katër) të dënuar.
- b. Janë paraqitur kërkesa nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për vendosjen në regjim të posaçëm dhe janë konfirmuar me vendim nga Ministri i Drejtësisë, për 4 (katër) persona.
- c. **Janë bërë ankime në gjykatë kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë për vendosje në regjim të posaçëm në 6 (gjashtë) raste, nga të cilat ka përfundur gjykimi dhe është lënë në fuqi vendimi për 1 (një) person dhe për 5 (pesë) personat e tjerë gjykimi nuk ka përfunduar brenda vitit 2021.**

### **c. Praktika administrative të ndryshme të zgjidhura gjatë vitit 2021.**

- Janë nxjerrë urdhërat e prokurorit për ekzekutimin e vendimeve penale për 171 të dënuar, duke krijuar praktikat përkatëse në bashkëpunim me prokurorët e çështjeve.
- Janë pregatitur vendimet për miratimin e takimeve të të paraburgosurve me familjarët e tyre për 173 (njëqindë e shtatëdhjetë e tre) raste, sipas kërkesave të të paraburgosurve apo avokatëve të zgjedhur prej tyre.
- Për të paraburgosurit në Regjim të Posaçëm është pranuar kërkesa për lejimin e një bisede telefonike në muaj me familjarët e tyre dhe pregatitur vendimi i prokurorit në 35 raste.
- Për të dënuarit me kohë prove bazuar në aktet ligjore në fuqi prokurori i çështjes nxjerr vendimin për përfundimin e dënimit për këta të dënuar. Gjatë vitit 2021, janë 11 të dënuar që kanë përfunduar dënimin dhe është nxjerr vendimi për përfundimin e këtij dënimi. Vendimi i është dërguar Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin i dënuari, duke vënë në dijeni dhe Gjykatën.
- Janë kthyer përgjigje institucioneve dhe shtetasve të ndryshëm, sipas kërkesave të ardhura në prokurori duke ju dhënë zgjidhje problematikave të paraqitura.
- Janë krijuar dosjet e ekzekutimit të vendimeve penale për çdo të dënuar.
- Është mbajtur regjistri elektronik dhe manual për çdo të dënuar duke shënuar të dhënat kryesore sipas kolonave përkatëse.
- Është mbajtur në mënyrë elektronike Regjistri i Konfiskimeve, sipas vendimeve të gjykatës dhe emrave të të dënuarve, ku përcaktohet qartë konfiskimi i pasurive të luajtëshme, të paluajtëshme dhe vlerat monetare përkatëse.
- Është mbajtur regjistri elektronik dhe manual për personat e vendosur në regjim të posaçëm.



## **5. Përgjimi i komunikimeve elektronike në kuadër të hetimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për vitin 2021**

Duke marrë në analizë veprimtarinë e Zyrës së Përgjimit për periudhën një vjeçare, vlerësohet se janë bërë përpjekjet maksimale duke përballuar me sukses volumin e punës, i cili do të identifikohet përmes paraqitjes së të dhënave statistikore në vijim. Prioritet për vitin 2021 ka qenë vënia në funksionim të plotë e Zyrës së Përgjimit dhe Bërthamës Komanduese Elektronike, si dhe zbatimi i dispozitave ligjore që normojnë veprimtarinë e kësaj Zyre.

Me qëllim funksionimin normal të Bërthamës Komanduese Elektronike në Prokurorinë e Posaçme, bazuar në propozimin e Prokurorisë së Posaçme, me Ligjin Nr. 47/2021 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*”, ndër të tjera, në nenin 20/1, qartësohet statusi për specialistët e bërthamës komanduese elektronike.

Referuar nenit 29 të ligjit Nr. 95/2016 “*Për Organizimin e Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin e Krimin e Organizuar*”, si dhe nenit 23 (dispozita kalimtare) të ligjit Nr. 69/2017, në muajin Dhjetor 2019 deri në datën 24.03.2021, procesi i përgjimit në interes të çështjeve hetimore të ndjekura nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është kryer në Sektorin e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike në Prokurorinë e Përgjithshme, ku është vënë në dispozicion një ambient i veçuar, zyrë pune, me qëllim realizimin e këtij procesi.

Me datë 18.03.2021, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në zbatim të ligjit 9157 datë 04.12.2003 neni 25/2 dhe në dispozitën kalimtare (Vendosur me ligjin nr.69/2017, datë 27.4.2017), njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të gjitha organet që kryejnë përgjimin e komunikimeve elektronike, sipas këtij ligji, se **me datë 24,03,2021 fillon funksionimi i Zyrës së Përgjimit** dhe Bërthamës Komanduese Elektronike në mjediset e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Gjithashtu me datë 18.03.2021, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, që brenda afatit 10 ditor sipas ligjit Nr. 9157, datë 04.12.2003, neni 25/3, të merren masat që çdo përgjim i autorizuar dhe që është duke u kryer në Prokurorinë e Përgjithshme, për veprat penale nën juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme, të transferohen në këtë prokurori duke propozuar edhe një procedurë që duhet ndjekur, ku administratoret e të dyja bërthamave komanduese të merren me koordinimin e veprimeve.

Afati i fillimit të përgjimit të numrave aktiv në sistemin e përgjimit në Prokurorinë e Posaçme, për grupin e parë të procedimeve, është ka filluar me datë 24.03.2021 ora 08:00. Po në të njëjtën datë dhe të njëjtën orë është edhe afati i mbarimit të përgjimit të numrave aktiv në sistemin e përgjimit në Prokurorinë e Përgjithshme për këtë grup procedimesh. Me datë 29.03.2021 është bërë transferimi i grupit të fundit të procedimeve aktive që ishin duke u kryer në Prokurorinë e Përgjithshme.

Me datë 18.03.2021, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, me kërkesë që referuar nenit 29, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin e Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin e Krimin e Organizuar”, si dhe nenin 25 (dispozitat kalimtare) të ligjit nr. 69/2017, të krijohen kushtet e nevojshme, si dhe një ambient i veçantë për dy oficerë të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, të cilët do të ndjekin përgjimin e numrave të kompanisë “ONE” deri në momentin e integritit të plotë të kësaj kompanie me sistemin tone të përgjimit, pasi kjo kompani ishte proces të ndryshimit të teknologjisë. Me 01.09.2021 është bërë transferimi i numrave aktiv “ONE” në Prokurorinë e Posaçme, duke u shkëputur përfundimisht nga sistemi i përgjimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

**Përgjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 129 procedime penale.** Kjo veprimtari, deri ne 01 Shtator 2021, është ndjekur nga 9 (nënte) Oficerë të Policisë Gjyqësore të Policë së Shtetit dhe 3(tre) Oficerë të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë së Posaçme.

Për periudhën një vjeçare, vlerësohet se janë bërë përpjekjet maksimale, sidomos nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Policë së Shtetit duke përballuar me sukses volumin më të madh të punës(*krahasuar me vitet e mëparshme*). Ngarkesa ka qënë prezente për arsye se numri i operatorëve (o.p.gj-të) ka qënë dukshëm jo në proporcion me volumin e punës.

Me datë 01.09.2021, 9 (nëntë) Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Policë së Shtetit ju bashkohet grupi i pare i Hetuesve te Byrosë Kombëtare te Hetimit prej 7(shtate) hetuesish, duke zbutur ndjeshëm ngarkesën e punës. Trajnimi i hetuesve te BKH-së për sistemin e përgjimit u bë në ambientet e zyrës së përgjimit, në dy faza në muajt Maj-Qershor-Korrik.

Eksperienca, profesionalizmi, ndjenja e përgjegjësisë për të kapur në kohë e vlerësuar drejt të dhënat e përfituara nga interceptimi, në disa raste kanë dhënë rezultate përtej dyshimit që ekzistonte ndaj subjektit të vendosur nën përgjim. Mbi të dhënat e interceptimit jashtë objektit të hetimit, është mundësuar regjistrimi i procedimeve penale më vehte.

Duke qënë se natyra e punës në zyrën e përgjimit është dinamike dhe duhet të ndiqet në kohë reale, Oficerët e Policisë se Shtetit dhe Hetuesit e BKH, për situata emergjente dhe operacionale, por edhe për shkak të ngarkesës së madhe të punës, kanë qëndruar në punë jashtë orarit, si në ditët zyrtare të punës ashtu dhe në ditët e pushimeve javore, vjetore dhe të festave zyrtare.

Në periudhën që analizojmë nuk ka ndodhur asnjë rast dekonspirimi i të dhënave të përfituara nga interceptimi. Oficerët e policisë gjyqësore/Hetuesit e BKH të Strukturës së Përgjimit të Komunikimeve Elektronike, krahas detyrimit për kalimin e informacionit në kohë dhe në dinamikë dhe përgatitjen në kohë të transkripteve të shkruara të materialit të përgjuar, garantojnë dërgimin e menjëhershëm të tyre prokurorit që ka kërkuar përgjimin. Numri i personave, të cilët mund të njihen me materialin e përgjuar është i kufizuar. Materiali i përgjuar nuk i vihet në dispozicion asnjë personi, i cili nuk ka kërkesë zyrtare ose nuk është i autorizuar për të marrë këtë informacion.

Administratoret, kane ushtruar përgjegjësinë që diktohet në rregulloren dhe urdhrat për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në funksion të realizimit të proceseve teknike të përgjimit të komunikimit elektronik, në bazë të neneve 221 deri 226 të Kodit të Procedurës Penale, vëmendja është përqendruar në marrjen dhe ekzekutimin në kohë të vendimeve të përgjimit; ruajtjen e sekretit hetimor; administrimin e ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me procesin e përgjimit dhe aktet që e shoqërojnë, trajnimin dhe mbështetjen nga ana teknike të hetuesve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, mirëmbajtja e sistemit, etj. Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme, janë mbajtur kontakte dhe komunikime me kompaninë që mbulon suportin teknik të sistemit të përgjimit. Gjatë këtij komunikimi, nga ana jonë, në funksion të mirëmbajtjes së sistemit, janë identifikuar një sërë problematikash, ku shumica prej tyre janë zgjidhur në kohë.

**Për vitin 2021**, Bërthama Komanduese Elektronike, ka ekzekutuar në interes të procedimeve penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:

- **411 Autorizime të Prokurorit** për lejim përgjimi;
- **1204 Vendime të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, nga të cilat:
  - 224 Vendime Lejim Përgjimi
  - 400 Vendime Vleftësimi
  - 580 Vendime Zgjatjeje

Gjatë vitit 2021, për veprat penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme, **janë interceptuar rreth 1500 subjekte përgjimi** (autorë të dyshuar apo që kanë dijeni për vepra penale), **1957 pajisje fundore** (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim) ku është rezultuar në **ndalimin e rreth 179 personave të dyshuar për krverje të veprave penale**.

Krahasuar me vitin 2020(*grafiku i mëposhtëm*) kemi një rritje të ndjeshme të ngarkesës.


STRUKTURA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE  
KRIMIT TË ORGANIZUAR

PASQYRË

PËRMBLEDHËSE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2021

	2021	2020
<b><u>PROCEDIME PENALE...</u></b> .....	<b>129</b>	<i>(91 në vitin 2020)</i>
<b><u>PAJISJE FUNDORE</u></b> .....	<b>1957</b>	<i>(1373 në vitin 2020)</i>
<b><u>SUBJEKTE</u></b> .....	<b>1500</b>	<i>(1175 në vitin 2020)</i>
<b><u>TE NDALUAR</u></b> .....	<b>179</b>	<i>(171 në vitin 2020)</i>
<b><u>AUTORIZIME PROKURORI</u></b> .....	<b>411</b>	<i>(391 në vitin 2020)</i>
<b><u>VENDIME GJYKATE</u></b> .....	<b>1204</b>	<i>(943 në vitin 2020)</i>
* 224 Vendime Lejimi		
* 400 Vendime Vleftësimi		
* 580 Vendime Zgjatje		
<b><u>URDHERA NDERPRERJEJE (PROKURORI)</u></b> .....		<b>13</b>
<b><u>PROCESVERBALE TRANSKRIPTIMI</u></b> .....	<b>8659</b>	<i>(7480 në vitin 2020)</i>
<b><u>CD / DVD</u></b> .....	<b>1917</b>	

## Paraqitja grafike sipas disa zërave krahasuar me vitin 2020



Në vitin 2021, pjesën më të madhe të procedimeve penale ku është kërkuar përgjimi, e kryesojnë ato të hetuara për veprën penale të korrupsionit (nenet 244, 245, 245/1, 258, 259, 319, dhe 319/ç, 328) me 67 procedime penale/850 pajisje fundore; më pas janë ato të hetuara për veprën penale të grupit të strukturuar kriminal në trafikimin e lëndëve narkotike (283/a/2, 333/a, 334) me 45 procedime penale/928 pajisje fundore. Më poshtë gjendet pasqyra më e detajuar e procedimeve penale sipas veprave penale për vitin 2021 për të cilat është kërkuar përgjimi telefonik.

Nga këto mund të përmendim disa procedime që janë finalizuar me masa të ndryshme sigurimi nga Gjykata.

**Procedimi 211 viti 2021**, regjistruar për veprat penale 287, 333/a, është finalizuar (*shkurt 2021*) me ndalimin e 3 personave dhe janë sekuestruar vlera monetare të konsiderueshme (rreth 18 milion Euro).

**Procedimi 102/2 viti 2020**, regjistruar për veprat penale 283/a, 333/a, 334, 319/ç, 259 është finalizuar operacioni, ku Prokurori i ka kërkuar Gjykatës caktimin e masave të sigurimit për 7 persona.

**Procedimi 199 viti 2020**, regjistruar për veprat penale të "korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", u finalizua me arrestimin e 11 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve shtetëror që kanë mbajtur funksione publike.

**Procedimi Nr. 277 viti 2020**, regjistruar për veprat penale të "korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", u finalizua me arrestimin e 11 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve shtetëror që kanë mbajtur funksione publike.

**Procedimi Nr. 36 viti 2019, Nr. 148 viti 2020, Nr. 178 viti 2020, 249 viti 2020, 251 viti 2020** regjistruar për veprat penale sipas neneve 283, 333/a, 334 të kodit penal, janë finalizuar operacionet me rreth 100 persona të arrestuar dhe u sekuestruan në cilësinë e provës sasi të konsiderueshme lëndë e dyshuar narkotike.



## **6. Sektorit i Ekspertizës në Prokurorinë e Posaçme.**

Sektorit i Ekspertizës në Prokurorinë e Posaçme ka filluar aktivitetin e tij me datë 16 Janar 2021. Gjatë periudhës Janar - Gusht është punuar për vënien në funksionim të sektorit ku është hartuar projekti dhe janë zhvilluar procedurat për blerjen e pajisjeve dhe programeve ekzaminuese.

Me kontratën datë 10.02.2021, të nënshkruar me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara këtij sektori i është akorduar fondi prej 30,241,187 (tridhjetë milion e dyqind e dyzet e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë për financimin projektit të paraqitur nga ana jonë “Për blerjen e pajisjeve dhe programeve në funksion të Sektorit të Ekspertizës”. Në kuadër të këtij projekti ka përfunduar blerja e pjesës më të madhe të pajisjeve dhe programeve të parashikuara, të cilat janë programet dhe pajisjet më të avancuara në drejtim të ekzaminimit të pajisjeve dixhitale.

Po kështu gjatë kësaj periudhe ekspertët e sektorit kanë asistuar prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe hetuesat e BKH-së në veprime të ndryshme procedurale që lidhen me provat dixhitale, si dhe kanë trajnuar një pjesë të stafit të BKH-së në lidhje me provat dixhitale. Gjithashtu është asistuar sektori përkatës në Institutin e Policisë Shkencore për realizimin e akteve të ekspertimit për të gjitha vendimet e ekspertimit që i përkasin Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Duke filluar nga muaji Shtator sektori ka filluar të pranojë vendimet e para të ekspertimit. Po gjatë këtij muaji u sigurua pjesa kryesore e pajisjeve dhe programeve ekzaminuese, si rezultat i projektit të sipërpërmendur, si dhe disa donacioneve nga misioni ICITAP.

Për periudhën Shtator-Dhjetor 2021 kanë ardhur për ekspertim pranë këtij sektori 118 vendime ekspertimi, për 174 telefona celularë, 50 kompjutera dhe 49 prova të tjera elektronike (DVR, USB, CD/DVD, kamera/aparate fotografike dixitale, etj). Gjatë kësaj periudhe nga ana e ekspertëve të sektorit janë realizuar 35 akte ekspertimi.

## **7. Aktiviteti administrativ i Prokurorisë së Posaçme për trajtimin e ankesave të paraqitura**

Drejtuesi i Prokurorisë ka hartuar dhe miratuar 691 urdhëra në funksion të ushtrimit të kompetencave që ka sipas ligjit Nr.95/2016.

Janë paraqitur 549 ankesa gjithsej. Drejtuesi i Prokurorisë ka dhënë zgjidhje duke dërguar për vlerësim 19 ankesa në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, 127 janë dërguar për verifikim në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, 268 ju është kthyer përgjigje dhe 135 janë arkivuar, si ankesa të përsëritura.

Janë paraqitur 756 kërkesa të ndryshme nga shtetas, avokatë dhe subjekte të ndryshëm të cilave ju është dhënë zgjidhje ligjore, nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe prokurorët përkatës.

Gjatë vitit 2021 nga Zyra e Regjistrimit janë verifikuar dhe është kthyer përgjigje për 824 kërkesa për informacion të ardhura nga institucione dhe individë të ndryshëm me objekt “informacion nëse janë në ndjekje penale”, konkretisht të dhënat sipas tabelës:

<b>Nr. Rend.</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Nr. i shkresave të dërguara</b>
	<b>Totali</b>	<b>824</b>
1	Prokuroria e Përgjithshme	121
2	SHÇBA	75
3	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	143
4	Kolegji i Posaçëm i Apelit	1
5	Drejtoria e Sigurimit dhe Informacionit të Klasifikuar	61
6	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	87
7	Këshillit i Lartë Gjyqësor	13
8	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	64
9	Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë	10
10	Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit	11
11	Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave	3
12	Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore	135
13	Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës	6
14	Drejtoritë Vendore të Policisë	10
15	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë	3
16	Kryegjyshata Botërore	1

17	Gjykatat Rretheve	7
18	Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë	2
19	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi	2
20	Avokati i Shtetit	3
21	Bashkitë e Rretheve	2
22	Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale	3
23	Drejtoria Rajonale e Rezervave të Shtetit	1
24	Agjensitë Shtetërore të Kadastrës	2
25	International Monitoring Operation	1
26	Kthim përgjigje shtetasve	42
27	Kthim përgjigje avokatëve	15

## 8. Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta

Sektori është përgjegjës për koordinimin e punës së saj me autoritetet e shteteve të tjera dhe shërben si ndërlidhës me organet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta, lidhur me kërkesat për ekstradim, marrëdhëniet me Zyrën Qëndrore të Interpol-it, etj.

Gjatë vitit 2021, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë trajtuar në total 91 kërkesa për ndihmë të ndërsjelltë juridike nga autoritetet gjyqësore të huaja, (nga të cilat 77 vetëm në vitin 2021) në bazë të konventave të Këshillit të Europës dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombetare ku Republika e Shqipërisë është pjesë. Të mbartura nga viti 2020, janë **14** letërporosi për të cilat vijon ende procedura për ekzekutimin e tyre.

Nga totali janë ekzekutuar **41** letërporosi dhe për vitin 2020 – 2021, **vijon ende procedura për ekzekutim për 50 letërporosi**. Këto kërkesa janë drejtuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja, për kryerjen e veprimeve në Republikën e Shqipërisë. Numri i madh i tyre, tregon për rëndësinë e veçantë që kjo prokurori i kushton bashkëpunimit ndërkombëtar.

Nga numri total i **77** kërkesave, **23** prej tyre, ose 29.87 %, janë kërkesa që kanë të bëjnë me hetime në fushën e “Trafikimit të narkotikëve”, “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”,

“Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 283/a, 283, 284/a, 333/a të tij.

Nga numri total i kërkesave, **29** prej tyre, ose 37.66 %, janë kërkesa që kanë të bëjnë me hetime në fushën “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të shoqëruara dhe me veprat penale në fushën e “Trafikimit të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 287, 283/a, 333/a të tij.

Kërkesat në lidhje me veprat penale të “Trafikimit të personave të rritur”, “Shfrytëzimit të prostitucionit”, “Trafikimit të të miturve”, “Ndihmes për kalim të paligjshëm të kufirit”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, të kryera në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenei 110/a, 114, 128, 298, 186, 189, 333/a të Kodit Penal, zënë 14.28 % të kërkesave ose **11** prej tyre.


Kërkesa në lidhje me veprat penale të “Vjedhjes”, “Mashttrimit”, “Vjedhje e energjisë elektrike” në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 134, 137, 139, 140, 143, 28, 333/a të tij, zënë 14.28 % të numrit total ose **11** prej tyre.

**1** (një) kërkesë ose 1.29 %, që ka të bëjë me hetime në fushën e veprave penale të “Korrupsionit pasiv i nënpunësve të huaj publikë”, “Fshehja e të ardhurave”, “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojrave të fatit”, “Përcaktimi i rezultateve në garat sportive” parashikuar nga nenet 180, 197, 197/a, 259/a, 333/a të Kodit Penal.

**2** (dy) ose 2.59 %, kërkesa që kanë të bëjnë me hetime në fushën e veprave penale të “Vrasjes”, “Vrasjes së mbetur në tentativë”, në formën e grupit të organizuar kriminal, parashikuar nga nenet 78, 78-22 dhe 333 të Kodit Penal.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Holanda me numrin më të madh të kërkesave, **20** kërkesa prej totalit prej **77** kërkesash, Belgjika **17** kërkesa, Italia me nga **10** kërkesa, Gjermania me **5** kërkesa, Kosova me **4** kërkesa, Franca me **3** kërkesa, Zvicra, Turqia, Mali i Zi, dhe Polonia me nga **2** kërkesa, dhe te tjerat janë Bullgaria, Rumania, Anglia, Spanja, Irlanda, Greqia, Peruja, Norvegjia, Azerbajxhani, Maqedonia e Veriut me nga **1** kërkesë.

### Letërporosi nga Jashtë



Krahas kërkesave për ndihmë juridike që lidhen me hetime të autoriteteve të huaja, lidhur me hetimet e Prokurorisë së Posaçme janë të nevojshme kryerja e veprimeve hetimore apo verifikimeve jashtë Shqipërisë. Për kryerjen e këtyre veprimeve janë përpiluar kërkesa për ndihmë të ndërsjelltë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja.

Përsa i përket këtyre kërkesave për vitin 2021, janë **51** kërkesa nga Prokuroria e Posaçme drejtuar autoriteteve të huaja. Kësaj shifre i shtohen dhe 16 kërkesa të mbartura nga viti 2020, për të cilat nuk është kryer ende ekzekutimi.

Nga këto **51** kërkesa, **9** prej tyre, ose 17.64 %, janë kërkesa që kanë të bëjnë me hetime në fushën e “Trafikimit të narkotikëve”, “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 283/a, 283, 333/a të tij.

Nga numri total i kërkesave, **2** prej tyre, ose 3.92 %, janë kërkesa që kanë të bëjnë me hetime në fushën “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të shoqëuara dhe me veprat penale në fushën e “Trafikimit të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal Shqiptar në nenet 287, 283/a, 333/a të tij.

Kërkesat në lidhje me veprat penale të të “Trafikimit të armëve dhe municionit”, në formën e bashkëpunimit atë të “grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 278/a, 333/a, janë **4** kërkesa, ose 7.84 %.


Kërkesat në lidhje me veprat penale të “Trafikimit të personave të rritur”, “Trafikimit të të miturve”, “Ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, të kryera në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 110/a, 128, 298, 333/a të Kodit Penal, zënë 39.21 % të kërkesave ose **20** prej tyre.

Kërkesat që kanë të bëjnë me hetime në fushën e veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e lidhur me subjektet e Prokurorisë së Posaçme, “Korrupsionit aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor”, “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 245, 260, 319, 328, të Kodit Penal, të cilat zënë 5.88 % ose 3 prej numrit total.

Në lidhje me veprat penale kundër terrorizmit dhe rendit dhe sigurisë publike “Vepra me qëllime terroriste”, “Financimi i terrorizmit”, “Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”, “Prodhimi i armëve luftarake”, “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve” dhe “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj”, në formën e bashkëpunimit asaj të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar si vepra penale nga Kodi Penal në nenet 230, 230/a, 232, 234, 265, 265/a të tij, janë 3 kërkesa, ose 15.88 %.

Dhe 1 prej tyre, ose 1.96 %, ka të bëjnë me veprën penale “Falsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve”, parashikuar si vepër penale nga Kodi Penal në nenin 190 të tij.

Ndarja sipas shteteve do të ishte, Italia dhe Greqia me numrin më të madh të kërkesave, me nga 8 kërkesa secila prej totalit, prej 51 letërporosish, Spanja dhe Holanda me nga 5 kërkesa secila, Gjermania 4 kërkesa, Mbretëria e Bashkuar dhe Kosova me 3 kërkesa, SHBA, Portugali, Maqedonia e Veriut, Franca, me nga 2, dhe të tjerat nga 1 janë: Kanadaja, Gjilbraltari, Çekia, Ekuadori, Turqia, Emiratet e bashkuara Arabe dhe Republika Domenikane.



Nga totali prej 51 kërkesa janë ekzekutuar 17, ndërsa pjesa tjetër është në pritje të përgjigjes nga autoritetet e huaja për ekzekutimin. Gjithashtu nga letërporositë e mbatura nga 2020, janë ekzekutuar 4 letërporosi në vitin 2021.

Një tjetër fushë e marrëdhënieve me jashtë, është dhe krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është duke ndjekur hetime me **10** Skuadra të Përbashkëta Hetimore. Të gjitha këto Skuadra janë krijuar me shtetin e Italisë, prej të cilave **3** janë të krijuara me Prokurorinë e Firence-s, **2** me Prokurorinë e Torino-s, **1** me Prokurorinë e Bergamo-s, **1** me Prokurorinë e Bari-t, **1** me Prokurorinë e Lecce-s, **1** me Prokurorinë e Pisa-s dhe **1** me Prokurorinë e Pordenone-s.

### **Veprat penale për të cilat kryejnë hetime:**

**5** Skuadra të Përbashkëta Hetimore, për hetime për veprat penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Trafikimit të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit atë të “Grupit të strukturar kriminal”, parashikuar nga nenet 287, 283/a, 333/a, 334 të Kodit Penal Shqiptar,

**2** Skuadra të Përbashkëta Hetimore të krijuara për veprat penale të “Trafikimit të narkotikëve”, në formën e bashkëpunimit atë të “Grupit të strukturar kriminal”, parashikuar nga nenet 283/a, 333/a, 334 të Kodit Penal Shqiptar,


**2** Skuadra të Përbashkëta për hetime lidhur me veprat penale të “Mashtrimi kompjuterik”, në formën e bashkëpunimit atë të “Grupit të strukturar kriminal”, parashikuar nga nenet 143/b, 333/a, 334 të Kodit Penal Shqiptar

**1** Skuadër për hetime për veprat penale të “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, në formën e bashkëpunimit atë të “Grupit të strukturar kriminal”, parashikuar nga nenet 298, 333/a, 334 të Kodit Penal Shqiptar.

Kjo prokurori gjatë peridhës në fjalë ka plotësuar praktikat për **17** kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri.

Krahasuar me vitin 2020, kemi një rritje të numrit të kërkesave për ndihmë juridike të ardhura nga jashtë shtetit për vitin 2021. Më poshtë kemi një tabelë në formë krahasimore për të gjithë treguesit të përmëndur më lart në raport me vitin 2020.





*Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Europian dhe vendeve fqinje. Konkretisht:*

- Në datë 02.06.2021, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunimin në Fushën Penale me Prokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës;
- Në datë 02.06.2021, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Prokuroria Bazë në Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

## **9. Bashkëpunimi me projektet e huaja të asistencës.**

- Gjatë vitit 2021, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është asistuar në punën e saj nga programe të SH.B.A.-së, të cilat synojnë përmirësimin e drejtësisë penale të Shqipërisë dhe sektorin e zbatimit të ligjit — Programi Tejoqeanik i Ndhmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë (OPDAT) dhe Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP), përfaqësues të së cilave janë të vendosur dhe fizikisht në ambientet e kësaj prokurorie.

Misioni OPDAT është përfshirë në rishikimin e legjislacionit të drejtësisë penale, trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve, oficerëve të policisë, në dhënien e pajisjeve për agjensitë zbatuese të ligjit si edhe dhënien e ndihmës teknike, me synim vendosjen e strukturave më efektive të zbatimit të ligjit. Nëpërmjet dy Këshilltarëve Ligjor Rezident, misioni ofron ekspertizë dhe asistencë prokurorëve lidhur me çështje konkrete, por edhe më gjerë në sistemin e drejtësisë si dhe ndihmë në marrëdhëniet ndërkombëtare të kësaj prokurorie duke e ndihmuar në luftën

e saj kundër krimit ndërkombëtar, korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit. Ndihma e OPDAT për Prokurorinë e Posaçme filloi me formimin e saj dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Misioni i OPDAT ka luajtur një rol të rëndësishëm, që nga themelimi i BKH-së, si pjesë e Komisionit të Pavarur të Rishikimit për BKH-në. Gjatë vitit 2021, një Këshilltar Ligjor Rezident i OPDAT-it vazhdoi të shërbejë si anëtar i këtij Komisioni, duke dhënë këshilla dhe udhëzime, si dhe duke monitoruar në mënyrë aktive procesin e përzgjedhjes, verifikimit dhe trajnimit të dy grupeve të hetuesve të BKH-së.

- Programi ICITAP, i cili që nga 1998, ka ndihmuar Qeverinë e Shqipërisë për të zhvilluar kapacitetet për të siguruar shërbime të zbatimit të ligjit mbi bazën e praktikave më të mira policore, respektimin për të drejtat e njeriut dhe të shtetit të së drejtës. Përfaqësues të këtij programi, të cilët janë atashuar fizikisht pranë Prokurorisë së Posaçme kanë vazhduar këtë mbështetje gjatë gjithë vitit 2021, duke u përqendruar në 4 faza kryesore:

- (a) finalizimin e procesit të përzgjedhjes dhe rekrutimit të grupit të parë të hetuesve të BKH-së;
- (b) përfundimin e programit bazë të trajnimit për hetuesit e BKH-së;
- (c) fillimi i procesit të përzgjedhjes dhe rekrutimit të grupit të dytë të hetuesve të BKH-së;
- (d) caktimin e një ish Agjenti Special Mbikëqyrës si këshillues dhe këshilltar për Drejtorin e BKH-së dhe skuadrën e hetuesve në zyrat e BKH-së.

- Projekti PAMECA V organizoi dhe zhvilloi veprimtaritë e mëposhtme:

Bashkërendoi dhe mbështeti SPAK/BKH për takimin me Drejtorinë Kombëtare Italiane kundër mafias dhe terrorizmit dhe me Drejtorinë Italiane për Hetimin kundër mafias (DIA). Për shkak të kufizimeve të covid-19, këto takime u mbajtën online dhe shërbyen për të shkëmbyer përvojat dhe praktikat më të mira në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Takimet u përqendruan në rritjen e bashkëpunimit të SPAK me kolegët italianë, strukturën organizative, modalitetet e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimin sa i takon skuadrave të përbashkëta hetimore etj.

Në bashkëpunim me SPAK u organizua trajnimi online për trajnuesit “Rreziku i fenomenit të korrupsionit në agjencitë ligjzbatuese shqiptare, nga një këndvështrim operacional; madhësia, ndikimi, strategjitë”. Trajnimi i trajnuesve u zhvillua për personelin e Departamentit të Planifikimit në Akademinë e Sigurisë.

Në bashkëpunim me Euralius, Shkollën e Magjistraturës, SPAK dhe Projektin Italian CSM-AICS, u lehtësua organizimi i seminarit “Format dhe elementet e çështjeve të korrupsionit të zyrtarëve të lartë”.

Në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Përgjithshme dhe SPAK, PAMECA V organizoi një seminar mbi prezantimin e ndryshimeve të fundit të ligjit për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale, që hyri në fuqi në gusht 2021.

Në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme organizoi një trajnim mbi komunikimin efikas me median dhe publikun, i cili u ndoq nga një hetues i BKH dhe Koordinatori për median i SPAK.

Gjithashtu, ky projekt mbështeti dy vizita studimore në Romë, Itali, përkatësisht, një trajnim operacional për 27 Hetues të BKH në Drejtorinë Hetimore Antimafia (DIA) për 5 ditë trajnimi; Trajnim i 3 prokurorëve të posaçëm mbi teknikat e strukturave të hetimit të krimit kompjuterik, në sektorë teknikë operacionalë dhe shërbimet e kriminalistikës të Policisë së Shtetit Italian dhe Karabinierisë; dhuroi dy automjete për përdorim BKH-së.

- Një tjetër mision, i cili operon dhe jep ndihmesë, në punën e Prokurorisë së Posaçme është projekti në kuadër të marrëveshjes "IPA 2019/Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor", i përfaqësuar nga Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar, Mbretëria e Hollandës. Projekti "Lufta kundër Krimit të Rëndë në Ballkanin Perëndimor", është vazhdimësi e projekteve të mëparshme, IPA 2010, IPA 2013 dhe IPA 2017. Ky projekt synon: forcimin e kapaciteteve operationale të autoriteteve ligjzbatuese dhe atyre të sigurisë të Ballkanit Perëndimor, në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (Mbështetje Operationale); mbështetjen e autoriteteve kombëtare përkatëse për të marrë pjesë në mënyrë efektive dhe për të kontribuar në strukturat e BE-së dhe ato rajonale (Bashkëpunimi Strategjik); forcimin e kapaciteteve të autoriteteve ligjzbatuese dhe atyre të sigurisë të Ballkanit Perëndimor, në shkëmbimin e informacionit (Ndërveprimi i Sistemeve të Informacionit).

Mbështetja operationale, konsiston ndihmën për strukturat e SPAK që në raste konkrete hetimore, janë përfshirë në skuadrave të përbashkëta hetimore (JIT) me vendet e tjera europiane nëpërmjet koordinimit, këshillimit dhe mbështetjes logjistike. Projekti ka organizuar dhe vazhdon të mbështesë disa takime operationale, në Shqipëri dhe jashtë vendit, mes prokurorëve të SPAK dhe homologëve të tyre nga vendet e rajonit si Kosova, Maqedonia e Veriut, etj, ashtu si dhe vendet dhe agjencitë e BE-së si Italia, Holanda, Franca, Eurojust, OLAF, etj.

Bashkëpunimi strategjik - projekti ka për synim forcimin e bashkëpunimit me agjencitë përkatëse të BE-së për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (p.sh. Europol, Eurojust), etj. Konkretisht, projekti organizoi, në tetor 2021, një vizitë të një delegacioni shqiptar nga SPAK dhe Prokurorisë së Përgjithshme në Eurojust, me pjesëmarrjen e Kreut të SPAK, dhe Prokurorit të Përgjithshëm, për të përruar Zyrën e Prokurorit Shqiptar Ndërlidhës në Eurojust. Gjithashtu, projekti organizoi takime dypalëshe dhe operationale me Prokurorinë Speciale Hollandeze.

Projekti mbështet financiarisht Zyrën e Prokurorit Ndërlidhës Shqiptar në Eurojust, duke mbështetur kështu rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar midis SPAK dhe vendeve anëtare të BE- së në luftën kundër krimit të organizuar transnacional dhe rritur kështu besimin mes institucioneve shqiptare dhe atyre evropiane.

Ndër veprueshmëria e sistemeve të informacionit - Projekti mbështeti nënshkrimin e Marrëveshjes Tripartite për dhënie të drejtës së qasjes në sistemin elektronik “SIENA - Aplikim i Sigurt i Rrjetit të Shkëmbimit të Informacionit”, “EUROPOL”, midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në kuadër të kësaj Marrëveshje tripartite, SPAK i shtohet listës së autoriteteve kompetente kombëtare që janë përgjegjës në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat kanë qasje të drejtpërdrejtë në sistemin SIENA të Europol. Në këtë kuadër, projekti po mbështet strukturat e SPAK, me pajisje, trajnime dhe ekspertizë të nevojshme për të krijuar qasjen e drejtpërdrejtë në kanalën e SIENA-s të Europol.

- Projekti EU4FOCAL, i financuar nga Bashkimi Europian, në kuadër të programit të asistencës IPA 2020, “Lufta kundër Krimit të Organizuar në Shqipëri nëpërmjet Hetimit Penal dhe atij Financiar”, është përfshirë në draftimin e një manuali, me qëllim azhurnimin e të dhënave në përsa i përket pastrimit të parave dhe konfiskimit të aseteve me prejardhje kriminale. Ky projekt, i cili është përfshirë dhe më parë përsa i përket draftimit të një manuali për pastrimin e parave, dhe në vitin 2021, ka kryer një sërë aktivitete në mbështetje të këtij qëllimi, duke krijuar një grup me prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme, SPAK dhe ekspertë të huaj, të cilët kanë filluar punën lidhur me tematikën e cila duhet të përfshihet në këtë udhëzues. Udhëzuesi do jetë një mjet praktik, për çdo profesionist që nga oficerët e BKH-së, prokurorë, oficerët të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, etj.
- Bashkëpunim në projektin e OKB, UNODC të përcaktuara në kuadër të Programit Rajonal për Evropën Juglindore për periudhën 2020-2023 me objekt “Dhënie fund pandëshkueshmërisë së trafikantëve dhe mbështetje e drejtësisë për viktimat e trafikimit në Evropën Juglindore”.
- Bashkëpunim me Qendrën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, në kuadër të implementimit dhe rishikimit të marrëveshjes për Planin e Përbashkët të Veprimit në Ballkanin Perëndimor Kundër Terrorizimit.
- Bashkëpunim ndërmjet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe SPAK mbi projektin e financuar nga BE “Mbështetje për një administrim më efektiv të drejtësisë në çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri përmes monitorimit të proceseve gjyqësore”.
- Bashkëpunim ndërmjet IOM dhe Prokurorisë së Posaçme, në kuadër të projektit rajonal për Ballkanin Perëndimor “Veprime të përbashkëta të Ballkanit Perëndimor kundër kontrabandës së migrantëve dhe trafikimit të personave”.

## 10. Aktiviteti i Koordinatorit për Mediat në SPAK

Bazuar në përcaktimet e nenit 24 të ligjit Nr.95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” (i ndryshuar), si dhe njoftimeve në faqen zyrtare të SPAK, gjatë muajit gusht të vitit 2021 u zhvillua procedura për përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozicionin “Koordinator për Marrëdhënien me Mediat”. Kandidati i përzgjedhur me konkurs publik filloi detyrën respektive në SPAK në datën 1 shtator 2021.

Përgjatë muajve të vitit 2021 Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat, nën drejtimin dhe bazuar në udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ka informuar publikun për punën e Prokurorisë së Posaçme nëpërmjet kontaktit me gazetarë respektivë të të gjitha mediave në Republikën e Shqipërisë, në rajon dhe më gjerë.

Në funksion të kërkesave për informacion hyrës dhe dalës në Prokurorinë e Posaçme, Koordinatori mban në mënyrë të vazhdueshme dhe të përditësuar “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”. Gjatë katër muajve të fundit të vitit 2021, kohë në të cilën u aktivizua Zyra për Marrëdhënien me Mediat në SPAK, regjistri i kërkesave për informacion rreth punës së SPAK dhe përgjigjeve nga ana e saj është monitoruar edhe nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. : “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve” tashmë publikohet edhe në faqen zyrtare të SPAK, në menunë “Programi i Transparencës”.

Përgjatë kësaj periudhe katër-mujore ka rezultuar të ketë konkretisht 27 (njëzetë e shtatë) kërkesa zyrtare për informacion.

Të shpërndara në muaj si vijon:

- 5 kërkesa për informacion gjatë muajit Shtator.
- 10 kërkesa për informacion gjatë muajit Tetor.
- 6 kërkesa për informacion gjatë muajit Nëntor.
- 5 kërkesa për informacion gjatë muajit Dhjetor.

Duhet theksuar se, në “kërkesa zyrtare për informacion”, të shënuara në Regjistër, nuk janë konsideruar pyetjet e ndryshme për komente që vijnë kryesisht nga gazetarët, të cilat janë pa diskutim të përditshme dhe më të shumta në numër se kërkesat zyrtare dhe lidhen me specifika të çështjeve dhe hetimeve të ndryshme nën kompetencën e Prokurorisë së Posaçme.

Ndaj të gjithave kërkesave zyrtare për informacion, ardhur nga gazetarë por edhe nga subjekte të ndryshme, është dhënë përgjigje e plotë dhe, për secilin rast, **brenda afatit të përcaktuar ligjor**. SPAK ka ofruar informata për palët e interesuara në çdo kohë dhe pa limitin e orarit zyrtar, në kohë reale dhe me çdo lloj platforme komunikimi sipas mundësisë, kur këto përgjigje ekzistojnë dhe nuk dëmtojnë thelbin e hetimeve.

Informacioni që i kërkohet SPAK, qoftë nëpërmjet kërkesave me shkrim / postës elektronike të institucionit, qoftë telefonikisht nëpërmjet Koordinatorit për Marrëdhënien me Mediat në SPAK, apo nga kërkesa specifike për të marrë intervistë, me incizim a me shkrim direkt nga Drejtuesi i SPAK është i lartë dhe vetëm në rritje të vazhdueshme.

Kërkesat për informacion variojnë që nga specifikat e hetimeve për çështje të ndryshme deri tek pushimet dhe mosfillimet e çështjeve hetimore. Në mjaft raste, kërkesa për informacion ka ngjarë më tepër edhe si një formë interviste, nisur nga numri i konsiderueshëm i pyetjeve të shtruara (deri në 15 pyetje për kërkesë).

Kërkesat për të marrë informacion i sjellin më së shumti subjektet për kallëzimet që kanë paraqitur, si dhe gazetarët vendas dhe të huaj, nga redaksi dhe OJF të ndryshme.

Gradualisht po bëhet një hapje e institucionit ndaj marrëdhënieve me publikun, duke përdorur çdo platformë të përshtatshme komunikimi. Kështu p.sh. SPAK përdor tashmë edhe rrjetin social “Twitter” si një formë tjetër e komunikimit efektiv me publikun krahas faqes zyrtare online. Twitter-i zyrtar i SPAK u hap gjatë muajit nëntor 2021, dhe komunikimi i parë nga kjo faqe u lançua në datën 23 nëntor.

Të qenit i hapur ndaj publikut dhe përgjegjësia për t’i kthyer sa më shpejt përgjigje të gjitha palëve të interesuara qëndron në themel të përmbushjes së një prej mision-qëllimeve të SPAK që lidhet me respektimin e plotë të së drejtës për informim.

Gjatë vitit 2021, duke ndjekur udhëzimet e dala nga Zyra e Komisionerit, SPAK publikoi në faqen zyrtare të institucionit “*Programin e Transparencës*”. Ky program transparence vjen në respektim të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; urdhrin Nr. 187, datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Si risi e lidhur me respektimin e së drejtës për informim, “Programi i Transparencës” pasqyron të gjithë informacionin e plotë lidhur me të drejtën për t’u informuar dhe për t’u ankuar, për të marrë informacion dhe kontakt të drejtpërdrejtë me Koordinatorin për Marrëdhënien me Mediat në SPAK, si dhe çdo informacion, kuadër ligjor, dokumentacion a shërbim që është gjykuar se mund të bëhet publik lidhur me autoritetin. Bashkëlidhur Programit të Transparencës gjenden gjithashtu “Modeli i kërkesës”, “Modeli i ankesës”, “Modeli i formateve për kërkim të informacionit / dokumentacionit”, që rekomandohet të përdoret për t’iu drejtuar zyrtarisht Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion.

## **11. Veprimtaria e Komisionit të Përzgjedhjes së Hetuesve të BKH-së**

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), përgjatë vitit 2021 shpalli njoftimin për konkursin për hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit, për 32 (*tridhjetë e dy*) vende vakante për hetues, në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, duke ftuar të interesuarit të dorëzonin aplikimet më datë 20.04.2021.

Rezultoi se aplikuan gjithsej 572 (*pesëqind e shtatëdhjetë e dy*) aplikantë.



Komisioni i Përzgjedhjes, i përbërë nga tre prokurorë të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentacionit përkatës të dorëzuar prej secilit prej tyre, në përfundim, me vendimin nr.1 datë 24.05.2021, konkludoi se 421 (*katërqind e njëzetë e një*) aplikantë, përmbushnin kushtet dhe kriteret ligjore për të vijuar me fazat e tjera të konkurrimit.

Pasi aplikantët iu nënshtruar fazave të tjera të konkurimit siç është testi i arsyesimit logjik, testi i esesë, testi fizik, testimi i aftësive fizike, intervistimi, faza për të cilat pati vendimmarrjet respektive nga Komisioni i Përzgjedhjes, ky i fundit përfundoi punën e tij më datë 31.07.2021 duke kualifikuar 75 (*shtatëdhjetë e pesë*) kandidatë. Këta të fundit, iu nënshtruan kontrollit të figurës dhe pasurisë, nga Komisioni i Vettingut i përbërë nga dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe një gjyqtar i Gjykatës së Posaçme të Apelit Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë. Në përfundim u arritën të kualifikoheshin dhe të përzgjidheshin 32 (*tridhjetë e dy*) kandidatë për hetues të BKH-së. Këta të fundit aktualisht i janë nënshtruar trajnimit.

I gjithë ky proces u bë i mundur në sajë të mbështetjes dhe nën mbikqyrjen e Komisionit Ndërkombëtar të Rishikimit, i përbërë nga ekspert të caktuar nga Ambasada e SHBA në Tiranë dhe Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë.

## **12. Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 2021.**

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme, i cili krijohet sipas pikës 12 të nenit 57, dhe e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të pikës 6, të nenit 6, dhe nenit 7 të ligjit. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ka në përbërje të tij dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, (nga tre anëtarë në tërësi) të zgjedhur me short, ku procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit.

Gjatë vitit 2021 Komisioni ka përfunduar verifikimet e plota të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 37 (tridhjetë e shtatë) kandidatë për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Gjatë vitit 2021 Komisioni ka filluar dhe ka vazhduar procesin e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës edhe për 74 (shtatëdhjetë e katër) kandidatë për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Po gjatë këtij viti Komisioni ka filluar dhe ka vazhduar procesin e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës edhe për 57 (pesëdhjetë e shtatë) punonjës të administratës së Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe për 2 (dy) kancelarë të Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit.



Ky Komision kryen një punë shumë voluminoze, pasi përveç vendimarrjes për kryerjen e verifikimeve nga ILDKPI dhe DSIK, vazhdon me analizën e thelluar të raporteve të përcjella nga këto dy institucione, për çdo subjekt verifikimi. Kryen verifikime të drejtpërdrejta në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme, Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Prandalimit të Pastrimit të Parave, SHISH, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamentin e Administratës Publike, etj.

Në rastin e kandidatëve për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, administron dhe analizon rezultatet e testit të poligrafit për çdo subjekt.

Pas administrimit dhe analizimit të të gjitha të dhënave të grumbulluara Komisioni përpilon dhe i përcjell institucionit të emërtesës raportin e hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës

Në përmbledhje gjatë vitit 2021 Komisioni ka përfunduar raportet e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës për **37 (tridhjetë e shtatë)** subjekte dhe kryen dhe vazhdon verifikimet edhe për **133 (njëqind e tridhjetë e tre)** subjekte.

### **13. Aktiviteti i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit**

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) pranë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka si qëllim menaxhimin, zhvillimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe ofrimin e suportit për sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) të institucionit, me qëllim krijimin e një ambjenti pune sa më efikas të sigurt, user-friendly dhe që ju vjen në ndihmë prokurorëve, hetuesve të BKH dhe stafit të administratës për kryerjen e punëve të përditshme. Është punuar në 4 drejtime, ku sistemet janë ndarë sipas kategorive dhe investimeve dhe është sqaruar i detajuar roli dhe puna e kryer nga DTI për çdo kategori si më poshtë:

- a. Rikonstruksioni dhe ndërtimi i infrastrukturës fizike
- b. Financimet nga partnerët ndërkombëtarë
- c. Qëllimi dhe puna e kryer deri tani
- d. Problematikat

#### **a. Rikonstruksioni dhe ndërtimi i infrastrukturës fizike**

Është ndërtuar një Infrastrukturë Informatike moderne si Datacenter i ri sipas parametrave teknikë, rrjete me shpejtësi të lartë transmetimi, si dhe sisteme kontrolli dhe sigurie për të garantuar sigurinë maksimale të institucionit.

## **b. Financimet nga partnerët ndërkombëtarë**

Nje ndihmë e madhe në fushën e IT është ofruar nga partnerët ndërkombëtarë si misionet ICITAP, OPDAT, EURALIUS, GIZ, etj. Mund të përmendim ndihmën në pajisje fizike dhe infrastrukture, ku rolin kryesor e ka ICITAP dhe një pjesë nga OPDAT, si dhe në sisteme software ku kanë ndihmuar ICITAP dhe EURALIUS.

Këto pajisje dhe software pasi merren në dorëzim nga DTI bëhet dokumentimi i plotë dhe integrohen në sistemet aktuale për tu shfrytëzuar maksimalisht potenciali i tyre fizik apo logjik përpunues për pajisjet fizike.

Për softwarët krijohet një ambient i sigurt pune me resurset e kërkuara si dhe mundësohet një dokumentim i plotë i kodit burim. Garancia për backup të plotë dhe të pavarur për të siguruar në raste avarie apo shkatërrimi të softit realizimin e kthimit në gjendje pune të sistemit 100% në një kohë minimale.

Deri tani është ngritur një infrastrukturë hardware moderne brenda godinës, e cila ju shërben punonjësve për realizimin e punës të përditshme, është ngritur një sistem “Domain Controller” dhe sistemi i postës elektronike zyrtare, sistem menaxhimi bazuar në infrastrukturën e Microsoft.

Sistem TIK i “SPAK” është llogaritur që të përballojë një trafik të dhënash shumë të lartë, pasi sipas ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” SPAK duhet të ketë akses te drejtpërdrejtë në të gjitha databazat shtetërore për të aksesuar në kohë reale informacionin e kërkuar për të shkurtuar kohën e aksesimit të të dhënave, ulur kostot nga komunikimi shkresor dhe ruan sekretin hetimor, pasi Prokurori apo Hetuesi nuk ka nevojë të kërkojë nga palë të treta informacionin.

Ne kuadër të këtyre zhvillimeve janë kryer lidhjet fizike dhe konfigurimet si më poshtë:

- Lidhje direkte me Fiber Optike (FO) me Policinë e Shtetit, ku është marrë akses në sistemin TIMS dhe sistemet e tjera që ofron ky institucion si E-gjoha, Depsee, Adam, Memex apo sisteme ndërkombëtare si Interpol, Europol etj.
- Lidhje me FO me Prokurorinë e Përgjithshme për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë në rastet e transferimit të dosjeve apo komunikimin elektronik të sistemeve.
- Lidhje me FO me Agjensinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nëpërmjet të cilës aksesohen pjesa më e madhe e databazave shtetërore e institucioneve që janë në GovNet, si dhe merrren shërbime të tjera, si licensimi i sistemeve të Microsoft, si Windows server, Exchange, Windows 10,11, paketa office etj.

## **c. Qëllimi dhe puna e kryer deri tani**

**Është realizuar akses në databazat shtetërore:**

- Database ku është marrë akses dhe përdoren aktualisht për qëllime hetimi janë 9 deri tani: *Sistemi i gjendjes Civile, ASHK, Drejtoria e Burgjeve, Regjistri i Llogarive Bankare, Sistemi elektronik i DPT, SEMD, DPSHTRR, TIMS.*
- Database që janë në proces dhe pritet të merret akses pasi ka përfunduar komunikimi shkresor dhe është dërguar lista e personave që do të përdorin janë 8:

*Regjistri Noterial Shqiptar, Regjistri Pronarëve përfitues, sistemet e Policisë së Shtetit ADAM, DEEPSE, E-Gjoha, Raporte Statistika, Memex, sistemi i APP.*

- Konfigurimi i lidhjeve klient server nëpërmjet VPN e cila garanton komunikimin të sigurt nëpërmjet rrjetit publik, si psh sistemi **AFMIS** i Ministrisë së Financave.
- Menaxhimi i kompjuterave të vjetër për të cilët janë marrë HDD të rinj të teknologjisë SSD të cilët rritin performancën dhe po ripërdoren sipas nevojave të institucionit për punonjësit e rinj të administrates, ose si kompjutera të dytë në shërbim të përdoruesve në rrjetin e klasifikuar.
- Suporti për përdoruesit fundorë duke asistuar me pajisjet fundore apo me trajnimet për pajisje të reja apo software te ndryshëm sipas nevojave të punës.
- Planifikimet për blerje të pajisjeve të ndryshme elektronike dhe informatike për përdoruesit të cilat plotësojnë standartet për të realizuar qëllimin e punës për të cilin do të përdoren.
- Komunikimet me institucionet e tjera shtetërore si AKEP, apo AKSHI për blerjen e emrave të domaineve, të cilët do të përdoren për publikimin në ëeb të faqes zyrtare, dhe kërkesat për servera me konfigurimet e nevojshme për hostim dhe akses nga interneti.
- Mbajtja në funksionim dhe filtrimi i të dhënave për lojet e sistemit të Aksesit për të gjithë përdoruesit në mënyrë periodike.
- Planifikimet për përmirësimin e infrastruktures dhe rritjes së sigurtisë të sistemeve duke e plotësuar me pajisje dhe sisteme të fundit.
- Ndarja e zonave të sigurtisë së godinës për të rritur sigurinë e qarkullimit të informacionit të gjeneruar në institucion apo sigurinë e informacioneve të ardhura nga organet e tjera qeveritare dhe krijimi dhe administrimi i një rrjeti fizik dhe logjik të klasifikuar sipas udhëzimeve dhe kërkesave të DSIK.
- Zhvillimi i faqes zyrtare të institucionit.
- Mirëmbajtja e pajisjeve fundore për menaxhimin e informacionit si fotokopje kombinat apo skanera qëndrorë për të realizuar një ambjent pune për sekretarët ligjorë për riprodhimin e materialeve hetimore sipas kërkesave.

#### **d. Problematika të konstatuara gjatë punës të DTI kanë qënë dy lloje:**

##### **1. Teknike**

Një nga problematikat e konstatuara është dorëzimi i pajisjeve të reja, të cilat janë blerë në kompani të ndryshme shqiptare apo globale, me vonesa të paparashikuara si pasojë e mungesës në treg të shkaktuar nga pandemia COVID, gjë e cila ka penalizuar lidhjen fizike të pajisjeve dhe rrjedhimisht ka shkaktuar vonesa në konfigurimet e sistemit.

Një tjetër problem i konstatuar ka të bëjë me pjesën e aksesit në sistemet elektronike të institucioneve të tjera që menaxhojnë databaza shtetërore, pasi sistemet në fjalë janë ndërtaur për përdorim nga stafi i institucionit dhe rolet e përdoruesve të krijuara kanë të drejta full (lexim, modifikim, fshirje te informacionit) që mundëson dhe ndryshimet në sistem, apo kanë të drejta të kufizuara në marrjen e informacionit, problem ky që duhet të zgjidhet teknikisht nga institucionet përkatëse për sistemet e tyre. Për këtë qëllim ju është kërkuar institucioneve në fjalë të bëjnë shtimin e një përdoruesi të ri në rolin e përdoruesit të jashtëm me të drejta

vetëm leximi për të marrë informacionin e kërkuar duke mos rrezikuar integritetin e informacionit nga modifikimet apo fshirja aksidentale.

## 2. Ligjore

Problem është baza ligjore për aksesimin e të dhënave sensitive nga palët e treta, e cila është e rregulluar me VKM për përcaktimin e personave të cilët kanë të drejtë të aksesojnë këto të dhëna. Për këtë arsye institucionet në fjalë po bëjnë ndryshimet e duhura të akteve nënligjore për të na mundësuar aksesin në të dhënat e tyre.

### 14. Plotësimi me personel administrative i Prokurorisë së Posaçme

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjatë vitit 2021, në mbështetje të Ligjit Nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”; Ligjit Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM-së Nr. 242 dhe 243 datë 18.03.2015 i ndryshuar “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, ka shpallur disa thirrje për plotësimin e vendeve vakante me personel administrativ në faqen zyrtare të SPAK. Nga këto procedura janë emëruar për vitin 2021 gjashtë (6) punonjës.

Sipas procedurës “Ngritje në detyrë” është emëruar Përgjegjësi i Sektorit të Regjistrave pranë Drejtorisë së Dokumentacionit dhe Burimeve Njerëzore;

Sipas procedurës “Lëvizja Paralele” dhe “Pranim në shërbimin civil” është shpallur thirrja për pozicionin **Specialist Ndërlidhës**, Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes ku është emëruar sipas procedurës “Pranim në shërbim civil” 1 (një) Specialist Ndërlidhës.

Gjatë vitit 2021 është shpallur disa here thirrje për vendin vakant në pozicionin “**Specialist IT**”, ku në thirrjen e parë nuk ka pasur kandidat/kandidate, i cili/e cila ka kandiduar për këtë pozicion, ndërkohë ky pozicion është rihapur në vitin 2021 dhe u finalizua me emërim në vitin 2022, pas fazës së intervistës së strukturuar me gojë ashtu siç parashikon “Lëvizja Paralele”.

Sipas procedurës “Lëvizja Paralele” dhe “Pranim në shërbimin civil”, është shpallur thirrja edhe për pozicionin **Specialist Statistikash**, Sektori i Regjistrave ku është finalizuar me përzgjedhjen e 1 (një) specialiste sipas procedurës lëvizja paralele.

Është shpallur thirrja për plotësimin e vendit vakant edhe në pozicionin “**Specialist Koordinator**” Sektori i Asistencës për Individët me Status të Posaçëm, por nuk ka pasur kandidat për të vazhduar më tej konkurimin.

Për vitin 2021 është shpallur edhe konkurimi për pozicionin “**Koordinator për Marrëdhëniet me Median**”, i cili u finalizua me sukses në bashkëpunim të ngushtë me OPDAT, duke përzgjedhur kandidaturën më të mirë.

Është zhvilluar dhe konkurimi për pozicionin **Specialist i Regjistrisë Sekret**, Sektori Protokoll Arkivë, duke përzgjedhur kandidaturën me pranim në Shërbimin Civil.

Më poshtë, tabela:

<b>Nr.</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Procedura e punësimit</b>
1.	Përgjegjës Sektori Regjistrave	Ngritje në Detyrë, Kategoria e ulët drejtuese (1)
2.	Specialist Ndërlidhës	Pranim në Shërbimin Civil, Kategoria ekzekutive(1)
3.	Specialist IT	Lëvizja Paralele, Kategoria ekzekutive (1)
4.	Specialist Statistikash	Lëvizja Paralele, Kategoria ekzekutive (1)
5.	Koordinator për Mardh.Median	Kategoria I-b (1)
6.	Specialist Regjistrisë Sekret	Pranim në Shërbimin Civil, Kategoria ekzekutive(1)

Gjatë vitit 2021 në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kanë ndjekur **trajnimin e detyrueshëm të ASPA, gjashtë (6) punonjës administrativ**, të cilët janë konfirmuar si punonjës me status të nëpunësit civil pas përfundimit të këtij trajnimi, mendimit pozitiv nga nëpunësi më i vjetër i njësisë organizative dhe vlerësimit një (1) vjeçar të punës.

Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar janë kryer dy trajnime mbi temat: “Për hartimin e dokumentacionit të Akreditimit të Sigurisë së sistemeve të komunikimit dhe Informacionit” dhe “Për hartimin e udhëzimit në zbatim të VKM nr. 542” dhe janë pajisur me çertifikatë trajnimi punonjësit pjesëmarrës.


Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me DSIK, ka pajisur me Çertifikatë Sigurie të gjithë prokurorët e posaçëm (Magjistratë), hetuesit e BKH-së, si dhe 35 punonjës administrative të Prokurorisë së Posaçme.

## **15. Analizë e të dhënave buxhetore të SPAK për vitin 2021**

Buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2021 është miratuar me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar, ku në total rezulton Buxheti Fiellestar të jetë i planifikuar në një vlerë prej 500 milion lekë, Këto burime financiare, SPAK si një institucion kushtetues, i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj.

Fondet buxhetore të miratuara përmes ligjit vjetor të buxhetit, SPAK i ka administruar për financimin e aktiviteteve në një program të përcaktuar me emertimin “Veprimtaria e SPAK”. Pesha specifike sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve, paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:

**Grafiku 1:** Pesha sipas llogarive ekonomike e planit të buxhetit 2021




**Burimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2021);

Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të SPAK, ashtu siç mund të konstatohet në grafikun më lart pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zënë llogaria “Paga” në rreth 70%, pas tij llogaria me peshën më të madhe është ajo e “Mallara dhe shërbime të tjera” me rreth 15%, ndërkohë që “Sigurime” zënë rreth 7% dhe “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë në vetëm nga 8%.

Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të instiucionit, kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës dhe kërkesat e SPAK për të përmbushur detyrimet ligjore.

Nga ana tjetër, pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve faktike të buxhetit 2021 mbi totalin e realizimit, paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:

**Grafiku 2:** Pesha sipas llogarive ekonomike e realizimit faktik të buxhetit 2021



**Burimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2021);

Nëse do të marrim në analizë peshën e llogarive ekonomike ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara sipas grafikëve 1 dhe 2 të mësipërm, evidentohet një ruajtje të peshës së këtyre shpenzimeve si në buxhetin e planifikuar ashtu edhe në atë të realizuar për vitin 2021. Qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të institucionit.

Viti 2021, ishte viti ku u punua intensivisht në konsolidimin e SPAK si institucion buxhetor dhe sigurisht është përballuar me sfida të mëdha në drejtim të ngritjes së strukturave të cilat do të hedhin themelet e institucionit të ri dhe do të sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm në vite. Gjatë viteve në vazhdim, do të synohet konsolidimi financiar dhe administrativ i institucionit me qëllim arritjen plotësisht të realizimit buxhetor dhe treguesve të performancës të përcaktuar në programin buxhetor afatmesëm 2022-2024.

